

V E N D I M
Nr. 434, datë 4.8.2000

**PËR STREHIMIN E FAMILJEVE TË INVALIDËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE, QË BANOJNË NË SHTËPI, ISH-PRONË PRIVATE, DHE PËR
FAMILJE TË PASTREHA TË INVALIDËVE**

Në mbështje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, të nenit 7, të ligjit nr.7652, datë 25.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sistemimin me banesa të familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qytetit të Tiranës, në rrugën “Don Bosko”, nga fondet e banesave të Entit Kombëtar të Banesave. Shpërndarja e tyre do të bëhet në bazë të listës (bashkëlidhur tabela), të dërguara nga Bashkia e Tiranës.

2. Sistemimin me banesa të familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qytetit të Durrësit në banesën tip 82/2, sek 15, me 15 apartamente, blloku në veri të stadiumit, nga fondet e banesave të Entit Kombëtar të Banesave. Shpërndarja e tyre do të bëhet në bazë të listës (bashkëlidhur tabela), të dëguar nga bashkia e Durrësit.

3. Fondi prej 27 500 mijë lekësh, për blerje banesash në tregun e lirë, për familjet e pastreha të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për qytetet Korçë, Shkodër, Shijak, Kavajë, Vlorë, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Punëve Publike, në zërin “Fondi i investimeve”. Shpërndarja e tyre do të bëhet sipas listës (bashkëlidhur tabela), të dërguar nga bashkitë përkatëse.

4. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave, të shoqëruara me strukturat përkatëse, vë në dispozicion të secilit qytetar të pastrehë, invalid lufte, shumën limit të përfitimit falas.

- për apartamente 1+1 shumën 1 707 milionë lekë

- për apartamentet 2+1 shumën 2 137 milionë lekë

- për apartamente 3+1 shumën 2 482 milionë lekë

Këto shuma do të indeksohen me vlerën e koeficientit “k”.

5. Fondi prej 18 600 000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh të kalojë, në llogari të veçantë, në Entin Kombëtar të Banesave, për tu përdorur për familjet e pastreha të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

6. Përdorimi i fondeve të mësipëme do të bëhet sipas radhës dhe përparësive, të përcaktuara nga shoqata e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

7. Enti Kombëtar i Banesave, para lidhjes së kontratave, të bëjë verifikimin e dokumentacionit në bazë të të cilit jan hartuar listat dhe në çdo rast shkeljeje të kritereve të caktuara të mos bëjë lidhjen e kontratës së shitblerjes me qytetarin.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave, organet përkatës të pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E INVALIDËVE TË LANÇ DHE STRUKTURA E APARTAMENTEVE
QË PËRFITOJNË

TIRANË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Bexhet	Mema	1+1
2.	Veiz	Pipa	1+1
3.	Hajro	Haxhia	2+1
4.	Islam	Poçi	1+1
5.	Koço	Koçi	2+1
6.	Liri	Belishova	2+1
7.	Luan	Leka	2+1
8.	Mihallaq	Papa	1+1
9.	Neki	Shima	1+1
10.	Nexha (Ganimet)	Hysi	1+1
11.	Njiaz	Cepani	2+1
12.	Pajo	Islami	1+1
13.	Safet	Kurti	3+1
14.	Servet	Hajdari	1+1
15.	Shpend	Dega	2+1
16.	Skënder	Peza	2+1
17.	Sulo (Sabrie)	Kozeli	1+1
18.	Tare	Çela	2+1

DURRËS

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Jaup	Stepa	1+1
2.	Memo	Hasana	3+1
3.	Gaqo	Rado	1+1
4.	Rexhep	Baçe	1+1
5.	Xhemal	Zenelaj	1+1
6.	Vlash	Kalavaçi	1+1

SHIJAK

Nr	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Sulejman	Zahiri	1+1

SUKTH

Nr	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Rahman	Patova	3+1

SHKODËR

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Baftjar	Xhindi	1+1

KAVAJË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Bejo	Gjoni	2+1
2.	Aqif	Ndreu	3+1

VLORË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Arif	Halilaj	1+1

KORÇË

Nr.	Emër	Mbiemër	Struktura
1.	Marko	Poda	1+1
2.	Hajredin	Qazimllari	2+1
3.	Polikron	Qyti	2+1